



REPUBLIKA E KOSOVËS
KUVENDI I KOMUNËS-SHTIME
Nr.01-060/01-21167/20 datë:21.10.2020



Npi – 01/241 datë: 29.10.2020

Duke u bazuar në nenin 12.2, pika (d) nenet 81 dhe 82 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040 (“Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës”, Qershor 2008); Kuvendi i Komunës së Shtimes, shqyrtoi kërkesën e Ministrisë për Administrimin e Pushtetit Lokal, Nr.020-668/3 të datës: 06.10.2020 për rishikimin e Vendimit të Kuvendit të Komunës së Shtimes Npi.01/179, të datës 31.08.2020 për këmbimin e pronës Komunale, me pronën e Bahri /Shaban/ Rexhaj nga fshati Petrovë. Kuvendi i Komunës, në mbledhjen e mbajtur më 29.10.2020, aprovoi këtë:

V E N D I M

PËR ANULIMIN E VENDIMIT TË KUVENDIT TË KOMUNËS SË SHTIMES **Npi – 01/179 TË DATËS: 31.08.2020**

I

Kuvendi i Komunës së Shtimes në mbledhjen e -VIII- të rregullt për vitin 2020, e mbajtur më 29.10.2020, me shumicën e votave vendosi të ANULOJË Vendimin e Kuvendit të Komunës së Shtimes, Npi-01/179, të datës 31.08.2020, për Këmbimin e Pronës së paluajtshme të Ngastrës Kadastrale Nr.985-2; Z.K-Petrovë, me sipërfaqe prej 699 m², si dhe pjesë të Ngastrës Kadastrale Nr.118-2; Z.K-Petrovë, me sipërfaqe prej 154 m². Totali sipërfaqeve: 853 m². Evidentuar pronë e Bahri /Shaban/ Rexhaj nga fshati Petrovë. Duke e këmbyer në sasi të barazvlefshme me pronën e paluajtshme të Komunës së Shtimes me Ngastrën Kadastrale Nr.724-0; Si dhe me pjesë të Ngastrës Kadastrale Nr.729-0; Z.K-Petrovë. Evidentuar Pasuri Shoqërore e Kuvendit Komunal – Shtime.

II

Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë nga dita e regjistrimit në zyrën e protokollit të Ministrisë përgjegjëse për qeverisje lokale, si dhe publikimit në ueb. faqen e Komunës së Shtimes.

III

Vendimi u dërgohet: Arkivit, Palëve, Drejtorisë, Kryetarit të Komunës, Ministrisë për Administrimin e Pushtetit Lokal dhe Zyrës për informim.



Kryesuesja e Kuvendit
Medina Brahaj